



Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe Ligjin Nr. 04/L-223, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, nxjerr:

VENDIM SHPJEGUES PUBLIK NR. 04/2016

TRAJTIMI I DONACIONEVE PËR QËLLIME TATIMORE

QËLLIMI

Qëllimi i këtij Vendimi Shpjegues Publik është të sqaroj trajtimin tatimor të Donacioneve për aspekte të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), Tatimit në të Ardhurat e Korporatave (TAK) dhe Tatimit në të Ardhurat Personale (TAP).

PËRKUFIZIM

Donacioni është ndihmë vullnetare dhe e pakushtëzuar në para, të mira materiale dhe shërbime, e cila nuk krijon dobi të drejtpërdrejtë për dhënësin as detyrim për kthim nga pranuesi i donacionit dhe e cila mund të jepet për qëllime të interesit publik ose për mbështetje të aktiviteteve të pranuesit.

BAZA LIGJORE

Neni 30, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 i Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH, përcakton lirimet tjera speciale lidhur me importimin, citojmë:

“2.1. importet e mallrave të financuara nga të ardhurat e donacioneve të bëra për buxhetin ose nëpërmes buxhetit të Kosovës ose nën mbikëqyrjen e organeve kompetente ose të financuara direkt nga kontratat për përfitim të Ministrive, autoriteteve lokale dhe organeve tjera të rregulluara me ligj, nga organizatat ndërkombëtare ndër qeveritare dhe agjencitë e tyre, qeveritë, agjencitë qeveritare, organizata qeveritare dhe jo-qeveritare në mbështetje të programeve humanitare dhe të rindërtimit dhe projekteve të tjera, përfshirë projektet e Integritimeve Evropiane në Kosovë”.

Neni 33, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 i Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH, përcakton lirimet në lidhje me transaksionet e caktuara që trajtohen si eksporte, citojmë:

“3.1. furnizimi i mallrave dhe shërbimeve të financuara nga të ardhurat e donacioneve të bëra për buxhetin ose nëpërmes buxhetit të Kosovës ose nën mbikëqyrjen e organeve kompetente ose të financuara direkt nga kontratat për Ministrinë, autoritetet lokale dhe organet tjera të rregulluara



me ligj, nga qeveritë, agjencitë qeveritare, organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare në mbështetje të programeve dhe projekteve humanitare dhe të rindërtimit, përfshirë projektet e Integritimeve Evropiane në Kosovë”.

Neni 5, paragrafi 5, nënparagrafi 5.4 i Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015 për zbatim të Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH, përcakton trajtimin e veprimtarive të organizatave jo-fitimprurëse, citojmë:

“5.4. Nëse një organizatë jofitimprurëse realizon njëkohësisht të ardhura nga anëtarësia, të ardhura nga fonde, grante dhe donacionet e ofruara nga subjektet private ose publike, vendas ose të huaj, si dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomike dhe pasuritë në pronësi të organizatës jofitimprurëse, atëherë kjo organizatë do të deklarojë dhe paguajë TVSH vetëm për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve nga veprimtaria ekonomike apo nga shfrytëzimi i pasurisë së organizatës, nëse si rezultat i kësaj veprimtarie ekonomike realizon qarkullim vjetor që kalon limitin për t’u regjistruar në TVSH”.

Neni 53, paragrafi 4, nënparagrafi 4.1 i Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015 për zbatim të Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH, përcakton lirimet në lidhje me transaksionet e caktuara që trajtohen si eksporte, citojmë:

“4. Bazuar në nenin 33, nënparagrafin 3.5 të Ligjit, do të trajtohen si eksporte, të liruar me të drejtë të zbritjes, furnizimi i mallrave dhe shërbimeve të bashkëfinancuara nga të ardhurat e donacioneve të qeverive të huaja dhe buxhetit të Kosovës për projekte të përfitimit publik, vetëm nëse:

- 4.1. Lirimi është i paraparë me marrëveshje në mes të palëve, ose*
- 4.2. Participimi i buxhetit të Kosovës nuk është më i madh se 20%”.*

Neni 4, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH, përcakton personat e tatueshëm, citojmë:

“1. Person i tatueshëm është secili person i cili është, ose kërkohet që të regjistrohet për TVSH dhe i cili në mënyrë të pavarur zhvillon një aktivitet ekonomik në mënyrë të rregullt apo jo të rregullt, pavarësisht nga qëllimi ose rezultati i atij aktiviteti ekonomik. Çdo aktivitet i prodhuesve, tregtarëve ose personave që furnizojnë mallra ose shërbime, duke përfshirë aktivitetet e minierave dhe ato bujqësore, të profesioneve, duhet të konsiderohet si aktivitet ekonomik. Eksploatimi i pasurisë së prekshme dhe të pa prekshme me qëllim të krijimit të të ardhurave nga ato në baza të rregullta, në veçanti duhet të konsiderohet si një aktivitet ekonomik”.

Neni 4, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH, përcakton se, citojmë:

“3. Në kuptim të këtij neni, nuk konsiderohet person i tatueshëm çdo organizatë jo-fitimprurëse për pagesa të përfituara nga anëtarësia, nëse kanë të tilla ose fonde, grante, donacione të përfituara për qëllime të veprimtarisë jo-fitimprurëse të organizatës, në përputhje me Ligjin përkatës për organizatat jo-fitimprurëse, përveç kur kjo organizatë përfiton pagesa si rezultat i veprimtarisë ekonomike”.

Neni 7, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Ligjit Nr. 05/L-029 për TAK, përcakton të ardhurat e liruar, citojmë:

“1. Të ardhurat si në vijim lirohen nga tatimi në të ardhurat e korporatave:

1.1. Përveç rasteve të parapara me nenin 34 të këtij ligji, të ardhurat e organizatave të regjistruara sipas legjislacionit për regjistrimin dhe funksionimin e organizatave si organizata

joqeveritare që kanë fituar dhe mbajtur statusin e përfituesit publik, me kusht që të ardhurat të shfrytëzohen vetëm për qëllime të përfitimit publik”.

Neni 7, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 i Ligjit Nr. 05/L-029 për TAK, përcakton të ardhurat e liruara, citojmë:

“Të ardhurat e përfituara nga grantet, subvencionet dhe donacionet, në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit.”

Neni 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.25 i Ligjit Nr. 05/L-028 për TAP, përcakton të ardhurat e përjashtuara, citojmë:

“Të ardhurat e përfituara nga grantet, subvencionet dhe donacionet, në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit.”

TRAJTIMI I DONACIONEVE PËR QËLLIME TË TVSH

Mallrat e importuara të financuara nga të ardhurat e donacioneve, sipas nenit 30, paragrafit 2, nënparagrafit 2.1 të Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH, lirohen nga TVSH në momentin e importimit. Gjatë kryerjes së procedurave të importit, me qëllim të lirimit nga TVSH për mallrat e blera të financuara nga të ardhurat e donacioneve, pranë autoritetit doganor, importuesi duhet të prezantojë dokumentet që dëshmojnë lirimin.

Projektet e financuara nga të ardhurat e donacioneve, sipas nenit 33, paragrafit 3, nënparagrafit 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH, trajtohen si transaksione të eksporteve, për të cilat furnizuesi i mallrave/shërbimeve, do të faturojë pa TVSH me të drejtë të zbritjes së TVSH-së së zbritshme.

Implementuesi i projektit, për të gjitha blerjet e mallrave/shërbimeve të parapara me projekt, lirohet direkt nga TVSH në blerje, nëse blerjet e tilla bëhen nga të ardhurat e donacioneve.

Personi, i cili përfiton donacione nga qeveritë, agjencitë qeveritare, organizatat qeveritare dhe joqeveritare në mbështetje të programeve dhe projekteve humanitare dhe të rindërtimit, përfshirë projektet e Integritimeve Evropiane në Kosovë, nuk kërkohet të regjistrohet për TVSH, pasi që të ardhurat e përfituara nga donacionet nuk janë objekt i tatuarjes për TVSH.

Personi i tatuashëm – deklarues i TVSH-së, mjetet monetare, të cilat i pranon në emër të donacionit dhe të cilat nuk prezantojnë konsideratën mbi furnizimin e mallrave/shërbimeve, nuk i përfshinë në deklaratën tatimore të TVSH-së. Pranimi i donacionit nuk është objekt i tatuarjes për TVSH pasi që nuk ka furnizim të mallit apo shërbimit, do të thotë nuk ka lindur ngjarja e tatuashme sipas nenit 3, paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH.

Furnizuesi i mallrave/shërbimeve, me rastin e faturimit, aty ku i ofrohet dëshmia nga blerësi se mallrat/shërbimet e blera financohen nga të ardhurat e donacioneve, faturimin do ta bëjë pa TVSH, duke shënuar në faturë referencën e nenit 33, paragrafit 3, nënparagrafit 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH.

Furnizuesi për të gjitha shitjet e bëra sipas nenit 33, paragrafit 3, nënparagrafit 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH, ka të drejtën e plotë të zbritjes së TVSH-së.

Shënim:

Edhe furnizimet që drejtpërdrejtë financohen nga Komisioni Evropian, trajtohen në të njëjtën mënyrë, siç është përcaktuar me këtë Vendim Shpjegues Publik.

TRAJTIMI I DONACIONEVE PËR QËLLIME TË TAP DHE TAK

Të ardhurat e përfituara nga grantet, subvencionet dhe donacionet janë të ardhura të përjashtuara, nëse janë në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit të përcaktuara në marrëveshjen në mes donatorit dhe përfituesit të donacionit.

Personi fizik afarist apo personi juridik, i cili tatóhet në bazë të të ardhurave reale, këto të ardhura i paraqet në pasqyra financiare në përputhje me Standardet Kosovare të Kontabilitetit.

Personi fizik jo afarist, personi fizik afarist apo personi juridik, i cili nuk tatóhet në bazë të të ardhurave reale, këto të ardhura, i trajton të ardhura të përjashtuara dhe nuk i përfshinë në deklaratën tatimore të periudhës. Pra, të ardhurat e tilla nuk përfshihen në qarkullimin e deklaruar në pasqyrën tremujore të tatimit.

HYRJA NË FUQI

Ky Vendim Shpjegues Publik, hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së.

Data: 09/08/2016

Sakip Imeri
Drejtor i Përgjithshëm i ATK

